



RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I GODINES , PALESTRES
DHE AMBJENTEVE JASHTME TE SHKOLLES SE MESME
"JANI NUSHI", BASHKIA LUSHNJE





QUELLIMI I RIKONSTRUKSIONIT





Rikonstruksioni i shkolles se mesme "Jani Nushi, Lushnje" eshte nje domosdoshmeri per komunitetin qe e frekuenton kete shkolle. Qellimi kryesor i ketij projekti eshte krijimi i kushteve sa me bashkekohore te mesimdhencies dhe jeteses ne hapesirat e kesaj shkolle.

Objekti perbehet nga kater volume. Volumi qendror 3 kate mbi toke dhe 1 kat nentoke, 1 volum 1kat, 1 volum 2kat dhe volumi i palestres.

Gjendja e degraduar e nderteses ekzistuese, ka bere qe te ulet numri i nxenesve qe e frekuentojnë ate duke shkaktuar dhe mbipopullimin e Gjimnazit me te afert ne zone.


Ne ambjentet e shkolles eshte e dukshme lageshtia, kushtet e degraduara te klasave dhe hapesirave ndihmese.





Kati -1 i objektit eshte krejtesisht i paaksesueshem.
Ne shkolle mungojne laboratoret e mirefillta .

Shkolla ka palester te mbuluar por ne kushte te degraduara.
Edhe pse palestra e shkolles perdoret per stervitjen e ekipit te volejbollit te qytetit, kushtet e saj jane ne gjendje te mjerueshme.
Prania e lageshtise, suvaja e degraduar ,mungesa e ngrohjes, dyshemeja e care ne shumicen e siperfaqes dhe mungesa e ambjenteve ndihmese te nevojshme e bejne te veshtire stervitjen ne kete hapesire.





Tarracat jane me solete dhe te amortizuara. Suvatimi i brendshem eshte i vjeter, i amortizuar, me valezime dhe i nje cilesie te dobet. Kangjellat e dritareve jane hekura me profil rrrethor te pa mirembajtura. Tualetet (WC) jane te amortizuara, totalisht jashte standartit te domosdoshem per tu afruar me direktivat e Bashkimit European.



Hapesira e zyres se drejtorit eshte shume e vogel.

Hapesira e bibliotekes eshte e pamjaftueshme.

Mungojne hapesirat e dedikuara per personat me aftesi ndryshe

Mungojne hapesirat sportive ne ambjentin e jashtem.

Mungan sistemi i ngrohjes, furnizimit me uje, kanalizimit te ujrate te bardha dhe te zeza.

Mungojne shkallet e emergjences.

Projektit i rikonstruksionit te shkolles eshte hartuar duke shfrytezuar te gjithe ambientet ekzistuese dhe duke bere nje rishperndarje te funksioneve ne keto hapesira. Eshte bere e mundur te realizohen mjediset e nevojshme, funksionale duke ndertuar klasa me parametra optimale.



Ne katin perdhe jane parashikuar hapesira e bibliotekes, salle studimi, klasa, tualete perndjem dhe vajza, tualetet P.A.N, palestra dhe hapesirat e saj ndihmese.

Ne katin e pare jane parashikuar salle per mesuesit, zyra e drejtorit, sekretaria, zyra e nendrejtorit, salla e informatikes, laboratori i kimise me ambjentin ndihmese, laboratori i biologjise me ambjentin ndihmese, klasa dhe tualetet.

Ne katin e dyte jane parashikuar klasa, laboratori fizikes me ambjentin ndihmese, tualetet.

Shkolla e rikonstruktuar do te kete nje rampe ne pjesen e hyrjes per personat P.A.N dhe shkallet e emergences ne pjesen fundore te korridorit. Ne shkolle eshte parashikuar ngrohja qendore e cila eshte me kaldaje me djegje me pelet. Ajo eshte vendosur ne katin nentoke. Gjithashtu jane parashikuar qe dritaret te jene duralumin dopio xham. Tarraca e volumit 3kat do te mbulohet me çati.

Jane parashikuar te gjithe zerat e rifinitures duke bere suvatim me fino te gatshme nga brenda dhe suvatim grafiato nga jashte. Termoizolimi do te realizohet me polisterol me sistem kapot $t=5\text{cm}$ nga te gjitha anet. Cilesia e materialeve qe eshte parashikuar te perdoren duhet te jete e larte sipas niveleve bashkekohore.





Hapesira e palestres do te organizohet me ambjentet ndihmese si dhomat e zhveshjes per meshkuj dhe femra, dhoma e mesuesit , hapesirat e dusheve dhe tualete.

HARTOI : ing Artur SINANI 
ark Alban MANOKU 